

Shoqata e Kontabilistëve të Çertifikuar dhe Auditorëve të
Kosovës

Society of Certified Accountants and Auditors of Kosovo

Raportimi Financiar
Financial Reporting

P5

Zgjidhjet

FLETË PROVIMI
Exam Paper

Data 29.09.2018

CONTENT / PËRMBAJTJA

Pjesa	Maksimumi i Dhënë	-Kujdes! Kjo pjesë është vetëm për përdorim nga ShKÇAK-PIKËT E DHËNA
1. Problemi 1	20	
2. Problemi 2	20	
3. Problemi 3	20	
4. Problemi 4	20	
5. Problemi 5	20	
Totali	100	

Problemi 1

Me 1 korrik 2017, Ohio sh.a bleu 60% të 4 milion aksioneve të zakonshme të Oregon sh.a në një këmbim prej dy aksione të Ohio sh.a për tri aksione të Oregon sh.a. Emetimi i aksioneve dhe investimi në Oregon sh.a nuk është regjistruar ende nga Ohio sh.a. Në datën e blerjes, aksionet e Ohio sh.a kishin vlerë të tregut prej €6 secila. Më poshtë janë draft pasqyrat financiare të të dy kompanive.

Pasqyrat e të ardhurave për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2017

	Ohio sh.a	Oregon sh.a
	€'000	€'000
Shitjet	85,000	42,000
Kosto e shitjeve	<u>(63,000)</u>	<u>(32,000)</u>
Fitimi bruto	22,000	10,000
Shpenzimet e shpërndarjes	(2,000)	(2,000)
Shpenzimet administrative	(6,000)	(3,200)
Kosto e financimit	(300)	(400)
Fitimi para tatimit	13,700	4,400
Shpenzimet e tatimit	<u>(4,700)</u>	<u>(1,400)</u>
Fitimi i vitit	9,000	3,000

Pasqyrat e pozitës financiare me 31 dhjetor 2017

	Ohio sh.a	Oregon sh.a
	€'000	€'000
Pasuritë		
<i>Pasuritë jo-qarkulluese</i>		
Prona, fabrika dhe paisjet	40,600	12,600
<i>Pasuritë qarkulluese</i>	<u>16,000</u>	<u>6,600</u>
Total pasuritë	56,600	19,200
Ekuiteti dhe detyrimet		
<i>Ekuiteti</i>		
Aksionet e zakonshme 1€	10,000	4,000
Fitimet e mbajtura	<u>35,400</u>	<u>6,500</u>
	45,400	10,500
<i>Detyrimet afatgjata</i>		
10% Notë krediti	3,000	4,000
<i>Detyrimet afatshkurtëra</i>	<u>8,200</u>	<u>4,700</u>
Total ekuiteti dhe detyrimet	56,600	19,200

Informatat në vijim janë të rëndësishme:

- i) Në datën e blerjes, vlerat e drejta të pasurive të Oregon sh.a ishin të barabarta me vlerat e tyre bartëse me përjashtim të fabrikës, e cila kishte vlerë të drejtë prej €2 milion më të lartë se vlera bartëse. Fabrika kishte jetë të mbetur të përdorimit prej pesë viteve në atë datë (zhvlerësimi drejtvizor). Oregon sh.a nuk e ka korrigjuar vlerën bartëse të kësaj fabrike si rezultat i vlerësimit të vlerës së drejtë.
- ii) Shitjet nga Oregon sh.a tek Ohio sh.a në periudhën e pas-blerjes ishin €8 milion. Oregon sh.a kishte një marzhë mbi kosto prej 40% në këto shitje. Ohio sh.a ka shitur €5.2 milion të këtyre mallrave (sipas koston) deri me 31 dhjetor 2017.
- iii) Nëse nuk është thenë ndryshe, fitimet ose humbjet ndodhin njëtrajtësisht gjatë kohës.
- iv) Të arkëtueshmet tregtare të Oregon sh.a me 31 dhjetor 2017 përfshijnë €600,000 të cilat ia ka borxh Ohio sh.a dhe nuk janë të barabarta me të pagueshmet tregtare koresponduese të Ohio sh.a-së. Kjo është për shkak të parasë në tranzit prej €200,000 nga Ohio sh.a tek Oregon sh.a. Që të dy kompanitë kanë saldo pozitive në bankë.
- v) Ohio sh.a ka një politikë të kontabilizimit të interesave jo-kontrollues sipas vlerës së drejtë. Vlera e drejtë e interesave jo-kontrollues në Oregon sh.a në datën e blerjes ishte vlerësuar të jetë €5.9 milion. Zëri i mirë i konsoliduar nuk është dëmtuar me 31 dhjetor 2017.

Kërkohet:

- a) **Përgadite pasqyrën e konsoliduar të të ardhurave për Ohio sh.a për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2017. (8 pikë)**
- b) **Përgadite pasqyrën e konsoliduar të pozitës financiare të Ohio sh.a me 31 dhjetor 2017. (12 pikë)**

(20 pikë)

Zgjidhja e Problemit 1

(a)

OHIO GRUP

Pasqyra e konsoliduar e të ardhurave për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2017

	€'000
Shitjet (85,000 + (42,000 X 6/12) - 8,000 (L1 7))	98,000
Kosto e shitjeve (ose L1 7)	
(63,000 + (32,000 x 6/12) - 8,000 shitjet ndër-grupore + 200(L1 2) + 800(L1 2))	<u>(72,000)</u>
Fitimi bruto	26,000
Shpenzimet e shpërndarjes (2,000 + (2,000 X 6/12))	(3,000)
Shpenzimet administrative (6,000 + (3,200 X 6/12))	(7,600)
Kosto e financimit (300 + (400 X 6/12))	<u>(500)</u>
Fitimi para tatimit	14,900
Shpenzimet e tatimit (4,700 + (1,400 X 6/12))	<u>(5,400)</u>
Fitimi i vitit	9,500
Fitimi i atribuar tek:	
Pronarëve të prindit	9,300
Interesave jo-kontrollues (L1 4)	<u>200</u>
	9,500

(b)

OHIO GRUP

Pasqyra e konsoliduar e pozitës financiare me 31 dhjetor 2017

	€'000
<i>Pasuritë jo-qarkulluese</i>	
Prona, fabrika dhe paisjet (40,600+12,600+ 2,000 kor. i VD -200 zhvl.)	55,000
Zëri i mirë (L1 3)	<u>4,500</u>
	59,500
<i>Pasuritë qarkulluese (16,000+6,600-800 FPR-600 arkt. ndër grup.+200 PT) ose L1 8)</i>	<u>21,400</u>
Total pasuritë	80,900
Kapitali aksionar (10,000 +1,600 këmbim i aksioneve)	11,600
Premia e aksioneve	8,000
Fitimet e mbajtura (L1 4)	<u>35,700</u>
	55,300
Interesat jo-kontrollues (L1 5)	<u>6,100</u>
	61,400
<i>Detyrimet afatgjata 10% nota krediti (3,000 + 4,000)</i>	7,000
<i>Detyrimet afatshkurtëra (8,200 + 4,700 - 400 (L1 10))</i>	<u>12,500</u>
Total ekuiteti dhe detyrimet	80,900

Llogaritjet

1. Struktura e grupit	%
Ohio sh.a në Oregon	60
Interesat jo-kontrollues	<u>40</u>
	100

Data e blerjes: 1 korrik 2017

Data e raportimit: 31 dhjetor 2017

Blerje ne mes të vitit, gjashtë muaj para përfundimit të vitit.

2. Neto pasuritë e Oregon

	Data e blerjes 1 korrik 2017	Data e raportimit 31 dhjetor 2017	Levizjet pas blerjes
	€'000	€'000	€'000
Kapitali aksionar	4,000	4,000	--
Fitimi i mbajtur:			
(6,500-(3,000×6/12)	5,000	6,500	1,500
Korigjimi i VD: Fabrika	2,000	2,000	--
Korigjimi i zhvlerësimit:			
Fabrika (2,000/5×6/12)	--	(200)	(200)
FPR në stoqe			
(40/140× (8,000-5,200)	<u>--</u>	<u>(800)</u>	<u>(800)</u>
	11,000	11,500	500

3. Zëri i mirë

	€'000
Kosto e investimit (60% × 4,000 × 2/3 × 6)	9,600
Vlera e drejtë e IJK-së në blerje	<u>5,900</u>
	15,500
Minus: neto pasuritë në blerje (L1 2)	<u>(11,000)</u>
Total zëri i mirë në blerje dhe konsolidim	4,500

4. Fitimet e mbajtura të konsoliduara

	€'000
Ohio sh.a	
Saldo me 31 dhjetor 2017	35,400
Pjesa e grupit e fitimeve pas blerjes së Oregon sh.a (60%×500 L1 2)	<u>300</u>
Në konsolidim	35,700

5. Interesat jo-kontrollues - Oregon sh.a

	€'000
Vlera e drejtë e IJK-së në blerje (L1 3)	5,900
Shto: Pjesa e IJK-së e fitimeve pas blerjes (40%×500)	<u>200</u>
Në konsolidim	6,100

6. Tregtia ndër-grupore

	D	K
	€'000	€'000
Anulo shitjet/blerjet ndër-grupore:		
Shitjet	8,000	
Blerjet		8,000
Elimino fitimin e perealizuar:		
Kosto e shitjeve/ fitimet e mbajtura $((8,000 - 5,200) \times 40/140)$	800	
Stoqet (PPF)		800

7. Kosto e shitjeve

	€'000
Ohio sh.a	63,000
Oregon (32,000 X 6/12)	16,000
Levizjet në korigjimet e VD (LI 6)	200
Blerjet ndër-grupore (LI 7)	(8,000)
FPR (LI 7)	<u>800</u>
	72,000

8. Pasuritë qarkulluese

	€'000
Ohio sh.a	16,000
Oregon	6,600
FPR në stoqe (LI 7)	(800)
Të arkëtueshmet ndër-grupore (sipas pyetjes)	(600)
Paraja në tranzit (LI 9)	<u>200</u>
	21,400

	D	K
	€'000	€'000
9. Paraja në tranzit		
Të arkëtueshmet		600
Të pagueshmet	400	
Paraja	200	

Problemi 2

Illinois sh.a, është një kompani e listuar në bursë me seli në Kosovë, e cila prodhon një gamë të gjërë të paisjeve të përgaditjes së ushqimit për përdorim shtëpiak. Në vijim është bilanci vertetues i Illinois sh.a me 31 dhjetor 2017:

	Debi	Kredi
	€'000	€'000
Shitjet		40,088
Kosto e shitjeve	18,000	
Shpenzimet administrative	10,600	
Shpenzimet e shitjes dhe shpërndarjes	3,680	
Interesi në notat e kreditit	420	
Dividenda e zakonshme e paguar	1,000	
Tatimi i paguar	1,620	
Aksionet e zakonshme 1€		32,000
Premia e aksioneve		18,500
Fitimet e mbajtura (1 janar 2017)		4,880
7% notë krediti (emetuar me 1 janar 2017)		12,000
Llogaritë e pagueshme		3,638
Lejimet për borxhet e dyshimta		512
Detyrim i tatimit të shtyrë (me 1 janar 2017)		670
Zhvlerësimi i akumuluar - Fabrika		300
Zhvlerësimi i akumuluar - Makineria dhe pasijet		1,440
Zhvlerësimi i akumuluar - Ndërtesa		3,360
Banka	6,700	
Llogaritë e arkëtueshme	3,200	
Stoqet	4,508	
Fabrika	800	
Makineria dhe pasijet	4,800	
Toka dhe ndërtesa	36,800	
Kosto e zhvillimit (me 1 janar 2017)	13,260	
Investimet	<u>12,000</u>	
	117,388	117,388

Shënimet në vijim janë të rëndësishme:

- i) Toka e cila ka vlerë bartëse sipas kostos prej €8.8 million është rivlerësuar në €10 milion me 31 dhjetor 2017. Është politikë e grupit të kontabilizoj tokën sipas vlerës së saj të drejtë.
- ii) Fabrika është blerë më kosto prej €800,000 me 1 janar 2016 dhe ka një vlerë të mbetur të vlerësuar prej €50,000 dhe jetë të përdorimit prej 5 viteve. Me 31 dhjetor 2017, Illinois sh.a është informuar nga një klient i madh që nuk do t'i blej më paisjet për përgaditjen e ushqimit nga Illinois sh.a për shkak të mbylljes së biznesit të tij. Rrjedhat neto të parasë të vlerësuar që do të fitohen nga fabrika për tri vitet e ardhshme do të jenë:

€'000

Viti i përfuduar me:

31 dhjetor 2018	180
31 dhjetor 2019	140
31 dhjetor 2020	150

Vlera neto e realizueshme e fabrikës me 31 dhjetor 2017 është vlerësuar se do të jetë €400,000. Kosto e kapitalit të Illinois sh.a është 10% dhe vlerat në vijim duhet të përdoren:

Vlera e €1 në:	Faktori skontues
Fund të vitit 1	0.91
Fund të vitit 2	0.83
Fund të vitit 3	0.75

- iii) Nga total investimet prej €12 milion, €5 milion ishin klasifikuar si të mbajtura për tregtim. Vlera e drejtë e tyre në fund të vitit ishte €6.5 milion. Pjesa e mbetur ishte klasifikuar si në dispozicion për shitje dhe vlera e tyre e tregut në fund të vitit ishte €8 million.
- iv) Kosto e zhvillimit është bartur në këtë periudhë nga dy vitet e mëparshme dhe produktet e reja kanë filluar të prodhohen për tregtim gjatë vitit aktual 2017. Prandaj, kosto e zhvillimit duhet të amortizohet përgjatë një periudhe prej 5 viteve duke filluar në vitin 2017.
- v) Në dhjetor 2017, kompania është paditur nga një ish punonjës për shkeputje të pabazë të kontratës. Me 31 dhjetor 2017, avokatët e kompanisë janë të mendimit se ish punonjësi ka një rast të drejtë dhe ka shumë mundësi që kompania do ta humbasë rastin në gjyq. Humbja është vlerësuar se do të jetë €450,000 dhe pritet që rasti do të përfundoj në shkurt të vitit 2018.
- vi) Nuk është kontabilizuar interesi i notave të kreditit për gjysmen e dytë të vitit.
- vii) Shpenzimi i tatimit për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2017 është vlerësuar se do të jetë €1,408,000 duke përfshirë ndryshimet në tatimin e shtyrë. Diferenca e perkohshme e tatueshme neto me 31 Dhjetor 2017 ishte €1,680,000. Norma e tatimit për vitin ishte 25%.

Tatimi i shtyrë nuk duhet të merret parasysh në rivlerësimin e pronës.

Kërkohet:

Në pajtim me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar, përgaditi pasqyrat financiare në vijim për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2017 për Illinois sh.a:

- a) Pasqyrën e të ardhurave dhe të ardhurave tjera gjithëpërfshirëse. (6 pikë)
- b) Pasqyrën e pozitës financiare. (14 pikë)

(total: 20 pikë)

Shënimet e pasqyrave financiare dhe fitimi për aksion nuk kërkohen.

Zgjidhja e Problemit 2**Illinois sh.a****Pasqyra e të ardhurave dhe të ardhurave tjera gjithëpërfshirëse për vitine përfunduar me 31 dhjetor 2017**

	€'000	€'000
Shitjet		40,088
Kosto e shitjeve		<u>(18,000)</u>
Fitimi bruto		22,088
Shpenzimet e shitjes dhe shpërndarjes		(3,680)
Shpenzimet administrative [10,600 + 100 + 2,652]		(13,352)
Provizioni për kompenzim		(450)
Kosto e financimit (420 + 420)		(840)
Ndryshimi ne VD të investimit (6,500 -5,000)		<u>1,500</u>
Fitimi para tatimit		5,266
Tatimi:		
Shpenzimet e tatimit aktual	1,658	
Shpenzimet e tatimit të shtyrë	<u>(250)</u>	<u>(1,408)</u>
Fitimi për periudhën		3,858
<i>Të ardhurat tjera gjithëpërfshirëse</i>		
Teprica në rivlerësimin e tokës (10m - 8.8m)	1,200	
Teprica në pasurinë financiare në dispozicion për shitje	<u>1,000</u>	<u>2,200</u>
Total të ardhurat gjithëpërfshirëse		6,058

Illinois sh.a**Pasqyra e pozitës financiare me 31 dhjetor 2017**

	€'000
<i>Pasuritë jo-qarkulluese</i>	
Prona, fabrika dhe pajset (800+4,800+36,800-300-1,440-3,360+1,200-100)	38,400
Pasuritë e paprekshme: Kosto e zhvillimit (13,260 - 2,652 amortizimi)	10,608
Investimet (12,000 + 1,500 + 1,000)	14,500
<i>Pasuritë qarkulluese</i>	
Stoqet	4,508
Llogaritë e arkëtueshme (3,200 - 512)	2,688
Paraja në bankë	<u>6,700</u>
Total pasuritë	77,404
<i>Ekuiteti dhe detyrimet</i>	
Aksionet e zakonshme 1€	32,000
Fitimet e mbajtura (4,880 + 3,858 - 1,000)	7,738
Rezervat tjera (18,500 + 1,200 + 1,000)	20,700
<i>Detyrimet afatgjata</i>	
7% Notë krediti	12,000
Detyrim i tatimit të shtyrë (1,680 x 25%)	420

Detyrimet afatshkurtëra

Tatimi i pagueshëm (1,658 -1,620)	38
Llogaritë e pagueshme	3,638
Interesi i përlllogaritur (12,000 *7%/2)	420
Provizioni për kompenzim	<u>450</u>
	77,404

Llogaritjet

L1: Tatimi i shtyrë

	€
Saldo me 1 janar 2017	670,000
Levizjet në tatimin e shtyrë	<u>(250,000)</u>
Saldo me 31 dhjetor 2017 (1,680,000 x 25%)	420,000

L1 2: Shpenzimet e tatimit

	€
Tatimi për vitin	1,408,000
(+) transfer nga TSH	<u>250,000</u>
	1,658,000
Taxtimi i paguar	<u>(1,620,000)</u>
Tatimi i pagueshëm	38,000

L1 3: Investimet në dispozicion për shitje

	€' milion
Kosto	7.0
VD	<u>8.0</u>
Teprica e rivlerësimit	1.0

LL 4: Prona, fabrika dhe paisjet

	Kosto/Riv	Zhvl i akm.	Humbja nga dëmtimi	Vlera bartese
Fabrika	800	(300)	(100)	400
Toka	10,000	-		10,000
Building (36,800 - 8,800)	28,000	(3,360)		24,640
Makineria dhe paisjet	4,800	(1,440)		<u>3,660</u>
				38,400

L1 5: Humbja nga dëmtimi

Vlera në përdorim

Viti		€
31 dhjetor 2018	180,000 x 0.91	163,800
31 dhjetor 2019	140,000 x 0.83	116,200
31 dhjetor 2020	150,000 x 0.75	<u>112,500</u>
		392,500

VNR = €400,000

Andaj, shuma e rikuperueshme = €400,000 (më e larta)

Vlera bartëse me 31 dhjetor 2017:

	€
Kosto	800,000
(-) Zhvlerësimi i akumuluar $(800,000 - 50,000) / 2 \times 5$	<u>300,000</u>
	500,000
Humbja nga dëmtimi:	
Vlera bartëse	500,000
Shuma e rikuperueshme	<u>400,000</u>
Humbja nga dëmtimi	100,000

Problemi 3

Utah sh.a është një kompani e cila mirret me shitje me pakicë. Në vijim janë rezultatet e saj për dy vitet e fundit.

Utah sh.a

Pasqyra e të ardhurave dhe të ardhurave tjera gjithëpërfshirëse për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2017

	2017	2016
	€'000	€'000
Shitjet	5,800	3,990
Kosto e shitjeve	<u>(4,123)</u>	<u>(2,863)</u>
Fitimi bruto	1,677	1,127
Shpenzimet e shpërndarjes	(193)	(177)
Shpenzimet administrative	<u>(218)</u>	<u>(126)</u>
Fitimi para interesit dhe tatimit	1,266	824
Interesi	(188)	(194)
Tatimi	<u>(108)</u>	<u>(120)</u>
Fitimi i vitit	970	510

Utah sh.a

Pasqyra e pozitës financiare për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2017

	2017	2017	2016	2016
	€'000	€'000	€'000	€'000
Pasuritë jo-qarkulluese		3,610		3,225
Pasuritë qarkulluese:				
Stoqet	580		460	
Të arkëtueshmet tregtare	460		280	
Paraja & ekuivalentët e parasë	200		160	
Total Pasuritë qarkulluese		<u>1,240</u>		<u>900</u>
Total Pasuritë		4,850		4,125
Ekuiteti dhe detyrimet				
Ekuiteti:				
Kapitali aksionar	1,000		1,000	
Fitimet e mbajtura	<u>1,525</u>		<u>555</u>	
Total Ekuiteti		2,525		1,555
Detyrimet afatgjata:				
Borxhi afatgjatë	<u>1,700</u>		<u>2,000</u>	
Total detyrimet afatgjata		1,700		2,000
Detyrimet afatshkurtëra:				
Të pagueshmet tregtare	400		320	
Mbitërheqja bankare	147		30	
Tatimi	108		120	
Akrualet	<u>47</u>		<u>100</u>	
Total detyrimet afatshkurtëra		<u>702</u>		<u>570</u>
Total ekuiteti dhe detyrimet		4,927		4,125

Shënim:

- (i) Stoqet në fillim të vitit 2016 ishin €500,000.
- (ii) Numri i aksioneve në emetim është 1,000,000 për të dy vitet.
- | | 2017 | 2016 |
|--|--------|-------|
| (iii) Çmimi i tregut të aksioneve në fund të vitit | €12.00 | €6.20 |

Kërkohet:

- (a) Llogaritë për të dy vitet koeficientët në vijim të Utah sh.a. (8 pikë)
- Përqindjen e Fitimit Bruto
 - Përqindjen e Fitimit Neto
 - Koeficientin Qarkullues
 - Periudhen e Grumbullimit e të Arkëtueshmeve Tregtare
 - Periudhen e Grumbullimit e të Pagueshmeve Tregtare
 - Kthimi në Kapitalin e Angazhuar
 - Fitimin për Aksion
 - Koeficientin Çmim/Fitim.
- (b) Drafto një raport për bordin e drejtorëve të Utah sh.a në të cilin ju e komentoni pozitën dhe performancën financiare të kompanisë. Përdori koeficientët e llogaritë nën (a) më lartë si bazë për komentet tuaja. (12 pikë)

(Total: 20 pikë)

Zgjidhja e Problemit 3

(a)

	2017	2016
Përqindja e Fitimit Bruto	€1,677/€5,800 = 28.91%	€1,127/€3,990 = 28.25%
Përqindja e Fitimit Neto	€970/€5,800 = 16.72%	€510/€3,990 = 12.78%
Koeficienti Qarkullues	€1,240/€702 = 1.76:1	€900/€570 = 1.58:1
Ditët e të Arkëtueshmeve Tregtare	€460/€5,800x365 = 29 ditë	€280/€3,990x365 = 26 ditë
Ditët e të Pagueshmeve Tregtare	€400/€4,123x365 = 35 ditë	€320/€2,863x365 = 41 ditë
Kthimi në Kapitalin e Angazhuar	€1,266/€4,148 = 30.52%	€824/€3,555 = 23.18%
Fitimi për Aksion	€970/€1,000 = €0.97	€510/€1,000 = €0.51
Koeficienti Çmim/Fitim	€12.00/ €0.97 = 12.37	€6.20/€0.51 = 12.16

(b) Për: Bordin e drejtorëve - Utah sh.a

Nga: Ndihmës Kontabilisti Financiar

Tema: Pozita dhe performanca financiare e kompanisë

Data: shtator 2018

Përqindja e Fitimit Bruto

Përqindja e Fitimit Bruto është rritur nga 28.25% në 28.91%, një rritje prej mbi 2.33% që është një trend pozitiv për kompaninë. Kjo është gjithashtu pozitive për faktin që shitjet e kompanisë janë rritur mbi 45%. Një rritje e kësaj shkalle ka qene një sfide për kompaninë të cilën e ka kaluar me sukses. Kjo rritje erdhi nga fakti që rritja e shitjeve ishte me e madhe se rritja e kostove të shitjes (44%). Por, duhet të kemi parasysh që blerjet janë rritur me një përqindje pak më të lartë se shitjet dhe ka rezultuar me stoqe në fund më të larta.

	2017	2016	% Increase
	€'000	€'000	
Stoqet në fillim	460	500	- 8.00%
Blerjet	4,243	2,903	46.16%
Stoqet në fund	(580)	(460)	26.09%
Kosto e shitjeve	4,123	2,863	

Përqindja e Fitimit Neto

Përqindja e Fitimit Neto është rritur nga 12.78% në 16.72% e cila është një rritje prej afro 31%. Kjo është një performancë shumë e mirë. Arsyeja kryesore për këtë rritje është përshkak të rritjes në shitje e cila që ka shpjer në rritje të fitimit bruto nga €1,127k në €1,677k, një rritje prej €550k. Kjo rritje është anuluar deri në një masë nga rritja në shpenzimet administrative prej €92k e cila është një rritje prej pak më shumë se 73%. Kjo rritje është e lartë dhe kompania duhet ta ketë këtë parasysh në të ardhmen.

Koeficienti qarkullues

Kjo është me pak se niveli i pranueshëm prej 2:1. Megjithatë, koeficienti qarkullues është rritur me mbi 11.39% që është një përmirësim. Arsyeja për këtë përmirësim është kryesisht për shkak të rritjes në pasuritë qarkulluese (rritje 37.78%) e cila është shkaktuar nga rritja në stoqe nga €460k në €580k një rritje prej mbi 26%, rritja në të arkëtueshmet tregtare prej €180k (rritje mbi 64%) dhe një rritje në para prej €40k ose 25%. Rritja në llogaritë e arkëtueshme nuk është një rezultat i shkëlqyer pasi që shitjet janë rritur me mbi 45% që tregon se mund të ketë pasur probleme me mbledhjen e

borxheve apo kompania është dashur të shes me afat pagese për t'i rritur shitjet. Megjithatë, nëse i shikojmë Ditët e të Arkëtueshmeve Tregtare e shohim se janë rritur me më pak se 12%. Ky nivel i rrites është me pak se rritja në shitje. Por, trendi është negativ dhe kompania duhet që të sjellë mbledhjen e llogarive të arkëtueshme në linjë me vitin e kaluar. Detyrimet afatshkurtëra janë rritur për 23.16%. Shkaktar kryesor ishte rritja në mbitërheqjen bankare prej €117k, një rritje prej 390%. Rritja në mbitërheqjen bankare ka ardhur nga blerja e pasurive jo-qarkulluese si dhe zvogëlimi i borxhit afatgjatë dhe një rritje në kapitalin punues. Të pagueshmet tregtare janë rritur për €80k apo 25%, por kjo rritje ishte kryesisht për shkak të zvogëlimit të akrualeve prej €53k.

Ditët e të Arkëtueshmeve Tregtare

Janë rritur nga 23 në 26 ditë, një rritje prej pak më shumë se 11%. Shitjet janë rritur me mbi 45% por kjo nuk është arsye për përkeqësimin e ditëve të grumbullimit të llogarive të arkëtueshme. Kompania duhet të siguroj që rritja në shitje nuk është për shkak të klientëve të cilët kërkojnë afat më të gjatë para se të blejnë mallrat nga Utah sh.a. Një arsye tjetër e mundshme është që departamenti i mbledhjes së borxheve ka qenë i dobët dhe duke parë rritjen në shpenzimet administrative, mund të supozojmë që ky departament ka pasur staf të mjaftueshëm për tu ballafaquar me volumin e punëve që ka ardh si rezultat i rritjes së shitjeve.

Ditët e të Pagueshmeve Tregtare

Janë zvogëluar nga 41 ditë në 35 ditë që është një përkeqësim prej mbi 14.63%. Ky nuk është rezultat i mirë pasi që kompania duhet të synoj të jetë mbi 45 dite. Me sa duket me rritjen e blerjeve disa furnitorë kanë aplikuar limite të blerjeve me afat pagese dhe kjo ka zvogëluar ditët e të pagueshmeve tregtare. Nëse e krahasojme me vitin 2016, diferenca ndërmjet ditëve të të arkëtueshmeve dhe të pagueshmeve është zvogëluar nga 15 ditë në 6 ditë gjë që bërë presion në rrjedhat e parasë drejt kompanisë.

Kthimi në Kapitalin e Angazhuar

Është rritur nga 23.18% në 30.52% që si përqindje është një rritje prej afro 32%. Përsëri ky është një rezultat shumë pozitiv. Shkaktar kryesor për këtë rritje është rritja e fitimit para interesit dhe tatimit prej €824k në €1,266k, një rritje prej €442k ose 53.64%. Kapitali i angazhuar poashtu është rritur nga €3,555k në €4,148k, një rritje prej €593k ose 16.68%. Rritjet kryesore ishin në pasuritë jo-qarkulluese dhe pasuritë qarkulluese të cilat i kemi diskutuar më lartë.

Fitimi për Aksion

Është rritur nga 51 cent për aksion në 97 cent për aksion, që është një rritje prej mbi 90%. Ky trend pozitiv është rezultat i rritjes në fitime të cilat kompania i ka realizuar në vitin 2017.

Koeficienti Ç/F

Ky koeficient është rritur pak nga 12.16 në 12.37, një rritje prej 1.73%. Ajo çfarë ka ndodhur është që rritja në FPA është anuluar nga rritja në çmimin e aksioneve nga €6.20 në €12 euro. Koeficienti aktual Ç/F është në një nivel të shëndoshë dhe në fakt investitorët janë mjaft të interesuar në kompaninë dhe fitimet e kompanisë dhe interesimi i investitorve e kanë ngritur çmimin e aksioneve dukshëm.

Problemi 4

(a) Objektivi i SNK 38 – Pasuritë e paprekshme është që të përshkruaj trajtimin në kontabilitet të pasurive të paprekshme të cilat nuk trajtohen në mënyrë specifike në ndonjë standard tjetër. SNK 38 kërkon që një entitet të njohë një pauri të paprekshme nëse dhe vetëm nëse kriteret e përcaktuara janë përmbushur. Standardi gjithashtu tregon se si duhet të matet vlera bartese e pasurisë së paprekshme dhe kërkon shpalosje të veçanta për pasuritë e paprekshme.

Kërkohet:

Shpjego:

- (i) Çfarë është një pasuri e paprekshme?
- (ii) Kur duhet që të njihet një pasuri e paprekshme?
- (iii) Në njohjen fillestare, bazat e matjes fillestare të një pasurie të paprekshme. (6 pikë)

(b) Ju sapo jeni çertifikuar si Kontabilist dhe jeni duke punuar me Hawaii sh.a dhe i raportoni kontrollorit financiar. Biznesi kryesor i kompanisë është shërbimi i taksive dhe autobusve në të gjithë Kosovën. Në qershor 2017, Hawaii sh.a-së i janë dhënë 40 licenca të taksive për zonën e Prishtinës. Komuna e Prishtinës e cila është përgjegjëse për rregullimin e shërbimeve të taksive dhe autobusëve publik vendosi në mars 2018 të ndërprej dhënien e licencave të taksive pasi që mendonte se kishte taksi të mjaftueshëm që mund t'i përmbushnin kërkesat e publikut për taksi.

Fillimisht Hawaii sh.a pagoi €100 për secilën licencë të taksit. Për shkak të vendimit të komunës së Prishtinës, kërkesa për këto licenca u rrit dhe në prill 2018 licencat e taksive janë duke u shitur dhe blerë lirshëm nga publiku në një ankand online i rregulluar në një web faqe për €500 për një licencë. Kontrollori financiar i Hawaii sh.a vlerëson se licencat do të kenë vlerë €1,000 secila në maj 2018. Hawaii sh.a nuk i ka rivlerësuar pasuritë e saj të paprekshme në vitet e mëparshme dhe fundviti i kompanisë është 30 prill.

Kërkohet:

Gjatë planifikimit për procesin e pasqyrave financiare të fund vitit kontrollori financiar ka kërkuar nga ju një memo në të cilën ju do të adresoni të mëposhtmet:

- (i) Pas njohjes fillestare, në çfarë baza mund të përfshihen licencat e taksive në pasqyrat financiare të vitit të përfunduar me 30 prill 2018?
- (ii) Cilat janë kriteret për rivlerësimin e pasurive të paprekshme?
- (iii) Në baze të informatave më lartë dhe duke supozuar që Hawaii sh.a do të adoptoj politikën e rivlerësimit për pasuritë e paprekshme, llogarite vlerën e licencave të taksive që mund të përfshihet në pasqyrat financiare për vitin e përfunduar me 30 prill 2018 DHE trego hyrjet e dyfishta të nevojshme për të regjistruar këtë transaksion.

(9 pikë)

(c) Komuna e Prishtinës rishtazi ka vendosur që të gjitha licencat e taksive të cilat me heret kishin jetë të pakufishme të përdorimit do të jenë të vlefshme vetem edhe për 5 vite tjera, dhe pas kësaj kohe do të jenë të pavlefshme.

Kërkohe:

Duke supozuar se sikur Hawaii sh.a të kishte adoptuar politiken e rivleresimit sipas pikës (b) (iii) më lartë, identifikoj trajtimin në kontabilitet që është i nevojshëm lidhur me vendimin e regullatorit të taksive DHE trego hyrjen e dyfishtë për të regjistruar këtë transaksion në vitin e ardhshëm.

(5 pikë)

(20 pikë)

Zgjidhja e Problemit 4

RAPORT

Për: Kontrollorin Financiar – Hawaii sh.a

Nga: Kontabilisti financiar i ardhshëm

Tema: SNK 38 – Pasuritë e paprekshme

Date: shtator 2018

(a)

- i) Paragrafi 8 i SNK 38 thotë që një pasuri e paprekshme është një pasuri e paidentifikueshme jo-monetare dhe pa substancë fizike
- ii) Sipas paragrafit 21 të SNK 38, pasuritë e paprekshme duhet të njihen nëse, dhe vetëm nëse:
 - a) Është e mundur që përfitimet e ardhshme ekonomike do të rrjedhin drejt entitetit; dhe
 - b) Kosto e pasurisë mund të matet me besueshmëri
- iii) Në njohjen fillestare, pasuritë e paprekshme duhet të maten sipas koston sipas paragrafit 24 të SNK 38.

(b)

- i) Pas njohjes fillestare, sipas paragrafit 74 të SNK 38 të pasuri duhet të bartet me koston e saj minus ndonjë zhvlerësim të akumuluar dhe minus çfardo humbje të akumuluar nga dëmtimi ose sipas paragrafit 75 të SNK 38 një pasuri e paprekshme duhet të bartet sipas shumës së rivlerësuar që është vlera e saj e drejtë në datën e rivlerësimit minus ndonjë zhvlerësim të akumuluar të mëpasëm dhe çfardo humbje të mëpasme të akumuluar nga dëmtimi.
- ii) Paragrafi 75 i SNK 38 thotë që rivlerësimet duhet të jenë sipas vlerave të drejta në datën e rivlerësimit duke iu referuar një tregu aktiv. Rivlerësimet duhet të bëhen rregullisht ashtu që në fund të periudhës raportuese dhe vlera bartëse të mos jetë materialisht ndryshe nga vlera e saj e drejtë. Një treg aktiv është një treg ku të gjitha kushtet në vijim ekzistojnë;
 - a) Artikujt e tregtuar janë identik;
 - b) Blerës dhe shitës të vullnetshëm mund të gjenden në çdo kohë;
 - c) Çmimet janë në dispozicion të publikut.
- iii) Nëse Hawaii sh.a dëshiron që të rivlerësoj licencat e taksive në pasqyrat e saj financiare për vitin e perfunduar me 30 prill 2018, duhet të përfshijë licencat e taksive me €500 secila, pra $40 \times €500 = €20,000$. €500 është çmimi i disponueshëm lirshëm me të cilin çdo anëtar i publikut mund blej licenca të taksit në një treg aktiv.

Hyrja e dyfishtë është si në vijim:

D	Pasuritë e paprekshme – PPF	€16,000	
K	Teprica e rivlerësimit- ekuitet - PPF		€16,000

Teprica e rivlerësimit në pasuritë e paprekshme do të tregohet gjithashtu në të ardhurat tjera gjithëpërfshirëse

- (c) Sipas paragrafit 97 të SNK 38, shuma e zhvlerësueshme e një pasurie të paprekshme me një jetë të kufishme të përdorimit duhet të alokohet në baza sistematike përgjatë jetës së përdorimit të saj. Amortizimi duhet të filloj kur pasuria është në dispozicion për tu përdorur dhe duhet të nderpritet në të mëhershmen nga data në të cilën pasuria klasifikohet si e mbajtur për shitje ose data kur pasuria nuk njihet më.

Metoda e amortizimit duhet të reflektoj mënyrën se si përfitimet e ardhshme ekonomike që rrjedhin nga pasuria pritet të rrjedhin në entitet dhe nëse kjo mënyrë nuk mund të përcaktohet në mënyrë të besueshme, atëherë duhet të përdoret metoda drejtvizore. Ngarkimi i amortizimit për secilen periudhë duhet të njihet në pasqyren e të ardhurave përveç nëse ndonjë standard tjetër kërkon që të përfshihet në vlerën bartëse të një pasurie tjetër. Licencat e taksive të Hawaii sh.a kanë një jetë të përdorimit prej 5 viteve dhe duhet të amortizohen në pasqyrat financiare përgjatë 5 viteve. Pasi që licencat e taksive janë rivlerësuar në €20,000, licencat do të amortizohen me shumën prej €4,000 në vit përgjatë pesë viteve të ardhshme (€20,000/5 vite). Hyrja e dysfishtë është si në vijim:

D	Amortizimi i pasurive të paprekshme – shpenzim PA	€4,000	
K	Pasuritë e paprekshme – PPF		€4,000

Nëse keni ndonjë pyetje tjetër mos hezitoni të më kontaktoni.

Sinqerisht i juaji
Kontabilisti financiar

Problemi 5

a) Washington sh.a iu shet makina të larjes klientëve të saj sipas kushteve të pagesës si në vijim.

Shitjet me shumicë:

Në momentin e nënshkrimit të kontratës – 25% të çmimit me pakicë

Në momentin e dergesës së makinave të larjes – edhe 25% të çmimit me pakicë

Shuma e mbetur duhet të paguhet brenda 12 muajve.

Shitjet me pakicë:

Në momentin e porositjes – 10% depozit

Në momentin e dërgesës – Pagesa e plotë (90%)

Kërkohet:

Diskuto kur duhet të njihen të hyrat nga Washington sh.a për shitjet e mësipërme. (5 pikë)

b) Pennsylvania sh.a shet makina të larjes me garancion i cili i mbulon të gjitha kostot e riparimit për çfardo defekti të prodhimit që paraqitet brenda 6 pas shitjes. Nëse paraqiten defekte të vogla në makinat e larjes të shitura do të shkaktohen kosto të riparimit prej €200,000. Nëse paraqiten defekte të mëdha atëhere do të shkaktohen kosto të riparimit prej €500,000. Përvoja e kompanisë tregon që në 6 muajt e ardhshëm, 85% e makinave të larjes nuk do të kenë defekte, 10% do të kenë defekte të vogla dhe 5% do të kenë defekte të mëdha.

Kërkohet:

Diskuto nëse duhet të ndahet ndonjë provizion për makinat e larjes dhe llogarite shumën nëse do të kishte provizion. (5 pikë)

c)

Ndërtesa e zyrës qendrore të Alabama sh.a është e vetmja ndërtesë në pronësi të saj, dhe me ndihmën e vleresuesve profesional e ka rivlerësuar këtë ndërtesë 1 janar 2017, me vlerë prej €2,100,000. Alabama sh.a ka adoptuar një politikë të rivlerësimit për ndërtesat nga kjo datë e rivlerësimit dhe ka vendosur që jeta e përdorimit është siq ka qenë në fillim dhe nuk ka ndryshuar si rezultat i rivlerësimit. Ndërtesa ishte blere me 1 janar 2007. Kosto e ndërtesës në blerje ishte €2,500,000 dhe zhvlerësimi i akumuluar deri me 31 dhjetor 2016 arriti shumen prej €500,000. Zhvlerësimi që nga blerja deri me 1 janar 2017 ishte bere në baza drejtvizore. Vleresuesit profesionist besojnë që vlera e mbetur e ndërtesës do të jetë €600,000 në fund të jetës së përdorimit.

Kërkohet:

Në pasjtim me SNK 16 - Prona, fabrika dhe paisjet:

- (i) si duhet të shpërndahet shuma e zhvlerësueshme e një pasurie? (1 pikë)**
- (ii) sa shpesh duhet të rishikohet vlera e mbetur dhe jeta e përdorimit të një pasurie? (2 pikë)**
- (iii) Llogarite shumen e zhvlerësueshme të ndërtesës për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2017 duke u bazuar në informatat e dhëna në skenarin e mësipërm. (7 pikë)**

[Total: 20 pikë]

Zgjidhja e Problemit 5

a)

Shitjet me shumicë:

Të hyrat mund të njihen në momentin e dërgesës së mallrave pasi që në këtë pikë rreziqet dhe shpërblimet janë transferuar tek blerësi.

Pasi që një pjesë e konsideratës është shtyrë, vlera e drejtë e konsideratës është më e ulët se shuma e saj nominale dhe duhet të skontohet duke përdorur një normë të nëkuptuar të interesit. Diferenca ndërmjet vlerës së skontuar dhe shumës nominale duhet të njihet si e hyrë nga interesi.

Shitjet me pakicë:

Të hyrat mund të njihen vetëm kur të dërgohen mallrat pasi që në këtë pikë rreziqet dhe shpërblimet janë transferuar tek blerësi dhe jo kur depoziti është paguar pasi që klientët mundën në çdo kohë të anulojnë porositë e tyre edhe pse ata mund ta humbin depozitin.

b) Një obligim aktual ekziston në fund të periudhës raportuese duke u bazuar në dëshmitë nga e kaluara të artikujve që janë riparuar sipas marrëveshjes për garancion. Një populatë e madhe e artikujve është në fjalë dhe prandaj duhet të ndahet provizion për vlerën e pritur të rrjedhave dalëse.

Shuma e provizionit:

$$85\% \times 0 + 10\% \times €200,000 + 5\% \times €500,000 = €0 + €20,000 + €25,000 = €45,000$$

c)

(i) Sipas paragrafit 6 të SNK 16, duhet të alokohet përgjatë jetës së përdorimit

(ii) Sipas paragrafit 51 të SNK 16, vlera e mbetur dhe jeta e përdorimit të një pasurie duhet të rishikohet se paku në fund të çdo fundvitit financiar dhe nëse pritjet dallojnë nga vlerësimet e mëparme, ndryshimi apo ndryshimet duhet të trajtohen në kontabilitet si ndryshim në vlerësimet kontabël në pajtim me SNK 8 *Politikat e kontabilitetit, Ndryshimet në vlerësimet kontabël dhe gabimet*

(iii) Shuma e zhvlerësueshme është si në vijim:

Llogaritjet - Prona, Fabrika dhe Paisejt	Ndërtesa €	Total €
kosto	2,500,000	2,500,000
- Zhvlerësimi i akumuluar	-500,000	-500,000
Vlera bartëse me 1 janar 2017	2,000,000	2,000,000
Përfitimi nga rivlerësimi	<u>100,000</u>	<u>100,000</u>
	2,100,000	2,100,000
Zhvlerësimi - ndërtesat - shënim 1	<u>-37,500</u>	<u>-37,500</u>
Vlera bartëse me 31 dhjetor 2017	2,062,500	2,062,500

Shënim 1

Ndërtesa – kosto në fillim	2,500,000
Ndërtesa – Zhvlerësimi i akumuluar nga fillimi	500,000
Zhvlerësimi i akumuluar / Kosto = 20%	

Ndërtesa është zhvlerësuar për 20% përgjatë 10 viteve (1 janar 2007 – 31 dhjetor 2016). Pra norma e zhvlerësimit ka qenë 2% (20%/10 vite pasi që pasuri është zhvlerësuar në baza drejtvizore që nga fillimi). Kështu që jeta e përdorimit e mbetur e pasurisë është 40 vite pasi që jeta e përdorimit në fillim ishte 50 vite (100%/2%).

Për të llogaritur shumën e re të zhvlerësueshme, ne do të përdorim formulën në vijim të zhvlerësimit

Shuma e rivlerësuar e pasurisë - vlera e mbetur = 2,100,000 - 600,000 = 1,500,000

Jeta e pritur e përdorimit të pasurisë 40 vite

Zhvlerësimi = 1,500,000/40 = 37,500

Nëse keni ndonjë pyetje tjetër mos hezitoni të më kontaktoni.

Sinqerisht i juaji

Kontabilisti financiar